V E N D I M
Nr. 556, datë 7.11. 2002

PËR SHKËMBIMIN E VILËS NR. 55, PRONË E SHTETIT SHQIPTAR, ME VILËN NR. 6, PRONË E MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, 5, 6, 10, 11, 13 dhe 14 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" dhe të nenit 757 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shkëmbimin e vilës nr. 55, së bashku me truallin nën të dhe oborrin rrethues, pronë e Shtetit Shqiptar, me adresë: Rruga "Skënderbeu", Blloku i Ambasadave, Tiranë, me vilën nr. 6, së bashku me truallin nën të dhe oborrin rrethues, pronë e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, me adresë: Lagja "Tirana e Re", rruga "Donika Kastrioti", Tiranë.

2. Shkëmbimi i këtyre dy vilave të kryhet pa shpërblim apo kompensim mbi vlerën e këtyre pronave.

3. Shkëmbimi të realizohet nëpërmjet një kontrate shkëmbimi, e cila të nënshkruhet për Palën Shqiptare nga një përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

4. Pas shkëmbimit, vila nr. 6 të administrohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano